



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministrastvo Administracije lokalne Samopravo
Ministry of lokal government Administration

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149, për Shërbyesit Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 neni 15 paragrafi 2 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civi, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Shpall:

KONKURS

I.Titulli i vendit të punës: Zyrtar për hartim dhe harmonizim të legjislacionit me legjislacionin e BE-së

Departamenti / Zyra:	Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave
Nr. i referencës:	MAPL
Grada e Vendit të punës:	9
Koeficienti:	7
Raporton:	Udhëheqësi i Divizionit
Lloji i Vendit të Punës:	Me orar të plotë
Mbikëqyrje e stafit:	0

Detyrat dhe përgjegjësitë

1. Të zhvillojë politikat dhe strategjitë e legjislacionit në bashkëpunim të ngushtë me udhëheqësin e divizionit dhe me njësitë e tjera organizative;
2. Të kryejë hulumtime ligjore lidhur me çështjet e politikave ligjore të cilat janë të lidhura me standardet e rregulloreve ndërkombëtare;
3. Të sigurojë informacione dhe të krijojë bazën e të dhënave lidhur me burimet e konsultuara (përmes internetit apo formave të tjera);
4. Të organizojë dhe të mirëmbajë bazën e të dhënave si dhe dokumentacionin i cili lidhet me ligjet dhe me rregulloret e miratuara nga ana e ministrisë si dhe ligjet dhe rregulloret më të rëndësishme të BE-së;
5. Të ofrojë këshilla juridike, rekomandime për njësitë organizative të ministrisë dhe të komunave lidhur me legjislacionin evropian, varësisht nga nevojat;
6. Të sigurojë informata dhe këshilla lidhur me gjërat aktuale në fushën të cilën e mbulon si dhe të përgatitë rekomandimet;
7. Të identifikojë dhe paraqesë problemet të cilat mund të shfaqen gjatë punës si dhe të propozojë zgjidhjet për punët e caktuara;
8. Të përgatitë informata dhe materiale për raportet periodike të punës, lidhur me çështjet ligjore;
9. Kryen edhe detyra tjera shtesë, sipas kërkesës së Udhëheqësit të Divizionit dhe Udhëheqësit të Departamentit.

Kualifikimet dhe Përvoja:

- Diplomë universitare në fushën e drejtësisë;
- Së paku 2 vite përvojë pune;
- Të ketë njohuri për parimet dhe procedurat e hartimit të legjislacionin;
- Të ketë njohuri për legjislacionin evropian që ndërlidhet me vetëqeverisjen lokale;
- Të ketë njohuri për legjislacionin e aplikueshëm, për çështjet të cilat kanë të bëjnë me MAPL-në;
- T'i njohë gjuhët zyrtare;
- Njohja e gjuhës angleze, e obliguar;
- Njohja e mirë e punës me kompjuter (aplikacionet Microsoft, internet etj).

Aktet ligjore dhe aktet nën -ligjore që rregullojnë rekrutimin

Rekrutimin e nëpunësve civil e rregullon Ligji Nr. 03/L -149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr.02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kohëzgjatja e emërmit

Kohëzgjatja e emërimit-punësimit është në përputhje me LSHCK Nr.03/L -149, në të cilën është e përfshirë periudha e punës provuese njëvjeqare për një pozitë (1).

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve

Formularët zyrtarë për aplikim merren në Zyrën e Personelit të MAPL-së, Kati XII -zyra 1203, ndërtesa ish-Rilindja, gjithashtu mund të tërhiqen edhe nga web Faqja e MAPL -së.

Kushtet për pjesëmarrje në rekrutim

Aplikacionet e plotësuara së bashku me kopjet e dëshmimeve për kualifikimet e nevojshme arsimore, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat dhe Vërtetimin nga Gjykata që personi nuk është nën hetime etj..., mund të dorëzohen drejtpërdrejtë në Zyrën e Personelit të MAPL-së dhe përmes postës.

Aplikacionet e pranuar pas afatit të caktuar, konsiderohen të papranueshme nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar (postuar), para kalimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve.

Aplikacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i plotësuar gabueshëm, do të konsiderohet i pavlefshëm dhe nuk do të merret në konsiderim.

Procedura e Konkurrimit

Procedura e konkurrimit është e jashtme dhe të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër/ngushtë do të kontaktohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Konkursi dhe kërkesa për punësim janë të publikuara edhe në ueb-Faqen e Ministrisë: mapl.rks-gov.net.

Për informata shtesë mund të kontaktoni Zyrën e Personelit të MAPL-së, në telefonin: 038-200 35-511